



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI I SHQIPËRISË

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.10.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – Kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 01.10.2018 dhe 02.10.2018.
2. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”. *(Nismë e Këshillit të Ministrave dhe nismë e deputetëve)*

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Arben Pëllumbi, Elena Xhina dhe Tom Doshi.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Alket Hyseni, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

#### **Të ftuar:**

Rovena Voda – Zëvendësministre e Brendshme  
Bledar Doracaj – Drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme  
Teuta Vodo – Zëvendësministre e Drejtësisë  
Iilir Bejko – Drejtor i Oponencës Ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë  
Viktor Gumi – ekspert  
Vangjel Kosta – ekspert  
Rajmonda Bozo – eksperte  
Rudina Brari – eksperte

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Meqenëse kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me rendin e ditës, sot kemi dy çështje: së pari, miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datës 01.10.2018 dhe 02.10.2018.

Ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratohen të dyja procesverbalet.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, shqyrtimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar” (nismë e Këshillit të Ministrave dhe e deputetëve).

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Brendshme zonja Rovena Voda, zëvendësministre, dhe zoti Bledar Doracaj, drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile; nga Ministria e Drejtësisë kemi zonjën Teuta Vodo, zëvendësministre, dhe zotin Ilir Bejko, drejtor i Oponencës Ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit, si dhe ekspertët: Viktor Gumi, Vangjel Kosta, Rajmonda Bozo dhe Rudina Brari, që kanë punuar me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”, si nismë e deputetëve.

Ju lutem, zini vendet!

Duke qenë se të dyja këto projektligje janë diskutuar dhe miratuar në parim në mbledhjen e kaluar të Komisionit të Ligjeve, po ashtu relatori dhe përfaqësuesit e të dyja ministrive, si dhe ekspertët, kanë punuar gjatë kësaj jave për të reflektuar disa nga shqetësimet që ngritën kolegët tanë në Komisionin e Ligjeve, unë them të fillojmë pa humbur kohë.

Zonja relatore, jeni gati të fillojmë me shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të këtij projektligji?

**Elena Xhina** – Po, zoti kryetar.

**Ulsi Manja** – Atëherë, vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar” (nismë e Këshillit të Ministrave).

U lutem paraprkisht përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë së Drejtësisë të shprehen për secilin nga nenet përpara se t’i hedhim në votim.

Fillojmë me nenin 1. Biem dakord?

**Rovena Voda** – Shprehemi dakord.

**Ulsi Manja** – Relatorja?

**Elena Xhina** – Për procedurë, zoti kryetar, do t'ju lutesha që të nisim fillimisht me propozimet e ndryshuara nga Këshilli i Ministrave, për të vijuar me ndryshimet e propozuara nga deputetët dhe më pas, kur ta hedhim në votim, ta hedhim si tekst integral të gjithë së bashku.

**Ulsi Manja** – Dakord, por...

*(Deputeti Shameti flet pa mikrofon.)*

**Elena Xhina** – Që të mos kemi konfondim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

Dakord me sugjerimin e relatores.

Të nderuar kolegë, unë kam këtu përpara, por edhe ju, një relacion të këshilltarëve tanë lidhur me të dyja projektligjet e propozuara, ndaj në fillim do të vazhdojmë me projektligjin e propozuar nga Këshilli i Ministrave.

**Bashkim Fino** – Ne si opozitë nuk kemi, keni vetëm ju andej, na e bëni kasten.

*(Ilaritet në sallë)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, kalojani një relacion opozitës!

Atëherë, biem dakord me nenin 1?

**Rovena Voda** – Shprehemi dakord.

**Ulsi Manja** – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2, sipas riformulimeve të propozuara. Kush është dakord?

Relatorja?

**Elena Xhina** – Po, jam për të bërë disa ndryshime, të cilat janë në marrëveshje me palët e interesuara.

**Ulsi Manja** – Hedhim në votim nenin 2!

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë te neni 3.

Kush është dakord me nenin 3, sipas variantit të riformuluar?

Fjalën e ka relatorja.

**Elena Xhina** – Neni 3 ka një riformulim në pikën 2 të tij, i bërë në marrëveshje me palët e interesuara.

**Ulsi Manja** – Pra, votojmë përmbajtjen e riformuar të nenit 3.

**Elena Xhina** – Po.

**Ulsi Manja** – Urdhëroni, Zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë po shoh se formulimi i nenit 3 është i njëjtë me variantin e qeverisë. Ku qëndron ndryshimi? Unë nuk shoh ndonjë ndryshim këtu. Varianti i qeverisë është: “Regjistri Kombëtar administrohet nga institucioni përgjegjës, i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Varianti i propozuar është: “Regjistri Kombëtar administrohet nga institucioni përgjegjës, i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.”

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, ka vetëm hyrjen, nuk ka amendament.

**Ulsi Manja** – Po ndryshimi është te hyrja. Ka edhe një ndryshim tjetër: te fjala vendim germa “V” është me të madhe.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull.

Atëherë, hedhim në votim nenin 3!

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Kalojmë te neni 4. A janë dakord përfaqësuesit e ministrisë me nenin 4?

**Rovena Voda** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Relatorja a është dakord me nenin 4?

**Elena Xhina** – Në këtë nen është hequr fjala “bashki”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

Keni tekstin integral përpara?

**Elena Xhina** – Neni 4 nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja** – Atëherë, hedhim në votim nenin 4!

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

Kalojmë te neni 5.

A janë dakord përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme dhe ata të Ministrisë së Drejtësisë me nenin 5?

**Rovena Voda** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Relatorja, a është dakord me nenin 5?

**Elena Xhina** – Ky nen nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja** – Atëherë, hedhim në votim nenin 5!

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Kalojmë te neni 6.

**Elena Xhina** – Ky nen nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja** – A janë dakord përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë së Drejtësisë me nenin 6?

**Rovena Voda** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Zonja Hysi ka një pyetje.

**Vasilika Hysi** – Unë kam një pyetje për drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Gjendjes Civile. Aktualisht, nëpunësit e gjendjes civile janë me status të nëpunësit civil?

**Bledar Doracaj** – Marrëdhënia e punës e nëpunësve të Zyrës së Gjendjes Civile në bashki dhe në prefektura rregullohet me Kodin e Punës.

**Vasilika Hysi** – Atëherë, cila është arsyeja që ne po shtojmë një nen për të përcaktuar marrëdhënien e punës për nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile?

**Bledar Doracaj** – Arsyeja është se para pak kohësh nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në prefektura për shkak të ligjit për nëpunësin civil, ishin të përfshirë në këtë ligj. Sot, për shkak të ndryshimeve, ata nuk janë më nëpunës civilë, por marrëdhënia e tyre rregullohet me Kod Punë. Ne kemi saktësuar që marrëdhëniet e zyrave të punës së gjendjes civile në bashki dhe në prefektura rregullohet sipas Kodit të Punës.

**Vasilika Hysi** – Zoti drejtor,

Meraku im i vetëm është, nëse ka nga këta punonjës që kanë fituar statusin e nëpunësit civil, sepse është ndryshim statusi.

**Bledar Doracaj** – Jo.

Siç u bë me VKM statusi për nëpunësit e prefekturave dhe për ata të nënprefekturave, po ashtu dolën para dy vjetëve nga Statusi i Nëpunësit Civil me Vendim të Këshillit të Ministrave.

**Ulsi Manja** – Dakord.

Hedhim në votim nenin 6.

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Ka një problem. Punonjësit e gjendjes civile nuk mund të kenë dispozita të Kodit të Punës dhe të trajtohen nga prefekti, sepse janë nëpunës të bashkive.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, kjo është tjetër gjë.

Në qoftë se gabimet që kanë bërë të tjerët kur kanë qenë në pushtet ne i kemi pranuar, kjo nuk do të thotë që na pëlqejnë dhe duhet t'i kemi akoma. Unë këtë e kam shumë dashamirëse dhe jam në kuadër të decentralizimit të pushtetit vendor. Punonjësit e bashkive duhet të operojnë me Statusin e Nëpunësit Civil dhe pasi ta kenë fituar këtë status të ketë të drejtë kryetari i bashkisë t'i emërojë. Nuk mund të funksionojnë me Kod Pune disa punonjës, të cilët (zoti kryetar, më ndihmo pak), duhet të jenë profesionistë. Me Kod Pune, unë, si prefekt i një qarku të caktuar, mund ta heq kur të dua një nëpunës të gjendjes civile, por ai që do të vihet në vend të tij duhet të ketë njohuri të caktuara. Nëse do të ketë Statusin e Nëpunësit Civil, do të ketë disa kritere, do të fitojë të drejtën të futet atje dhe është më e vështirë për ta zëvendësuar në çdo kohë. Kjo është ideja jonë për ta rregulluar.

Ne po bëjmë një projektligj për gjendjen civile për t'u ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë jashtë shtetit, por të fusim një nen që marrëdhëniet e punës për punonjësit e gjendjes civile të rregullohen me Kod Pune nga prefekti, nuk është normale, sepse thelbi i ligjit që na ka sjellë qeveria është tjetër gjë. Është më parimore dhe më e drejtë të themi shqyr që po kalojmë disa nene se si të ndihmojmë shqiptarët jashtë atdheut kur nuk kanë regjistruar fëmijët e tyre. Ndihma është që të vijnë në shtetin tonë dhe të regjistrohen menjëherë. Ky është thelbi i projektligjit, jo që ne t'i japim të drejtë prefektit të emërojë disa nëpunës kur t'i dojë qejfi. Ndërhyrja që bëri zonja nënkryetare ishte shumë e drejtë. Problemi është, nëse e ke, pse e cilëson prapë. Nëse e ke, a mund ta rregullojmë ne me dispozitë që t'ia kalojmë Departamentit të Administratës Publike? Ne kemi rënë dakord me Bashkimin Europian që të gjithë nëpunësit civilë do të operojnë me këtë status. Një pjesë e bashkive funksionon me status, kurse një pjesë e vogël është në funksion të prefekteve.

Dua një sqarim nga Ministria e Brendshme për këtë nen, që nuk është për thelbin e ligjit dhe pastaj të votojmë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e ka zonja Voda.

**Rovena Voda** – Në këtë rast si shpjegim do të përdor analogjinë. Punonjësit e zyrës së gjendjes civile janë punonjës që ofrojnë shërbime. Për këtë shkak jemi munduar të mbajmë të njëjtin standard si në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ashtu edhe të ALUIZNI-t.

Në radhë të parë, në rresht të parë, ne i kemi kategorizuar në punonjës që do të lidhin marrëdhëniet e punës në bazë të Kodit të Punës. Me sa di unë, ky qëndrim është mbajtur edhe në frymën e ligjit për nëpunësin civil edhe kur është bërë kategorizimi i nëpunësve të shërbimit civil.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** - Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Kam përshtypjen se nuk keni gjetur shembullin e saktë për të më mbushur mendjen mua. Nuk është vetëm punonjësi i gjendjes civile punonjës shërbimi, por çdo punonjës në bashki është punonjës shërbimi në funksion të komunitetit. Edhe kryetari i bashkisë është në shërbim të komunitetit që e ka votuar, pavarësisht se është i zgjedhur dhe jo i emëruar. Të më thoni për analogji që, siç janë punonjësit e ALUIZNI-t, që do bëjnë një shërbim ...

Zonja Zëvendësministre, mos harroni që punonjësit e ALUIZNI-t janë të përkohshëm, mbase deri në fund të mandatit, sepse do të mbarojë procesi i ALUIZNI – t dhe nuk do të ketë më. Gjendja civile është e përvetshme. Do të jetë gjithë kohën. Regjistri do të jetë aty. Nuk mund të thuash se, meqenëse punonjësit e ALUIZNI-it janë të përkohshëm dhe janë në radhët e para të shërbimeve, pra u shërbejnë njerëzve për të legalizuar një ndërtesë, edhe ata, për analogji, janë njerëz në shërbim të qytetarëve për t'u dhënë një certifikatë. Absolutisht që nuk është e njëjta gjë, është komplet e kundërta. Ata janë për katër pesë vjet, kurse këta do të jenë për gjithë jetën. Logjika është: ose do të kemi një standard për të gjithë nëpunësit, qofshin këta edhe në nivelin e ministrisë sate, të cilët i kemi me shërbim civil, ose do të kemi dy standarde.

Sugjerimi tjetër: a është mbledhur DAP-i për këtë nen? Zoti kryetar, kur preket nëpunësi civil, duhet marrë mendimi i DAP-it, që mund të thotë se mund ta përjashtojë nga listimi i punonjësve në DAP, ose, jo, duhet të jetë patjetër në këtë listim. Në momentin kur nuk është marrë, kjo nuk mund të lihet në qejfin dhe në dëshirën, pa fyer njeri, as të ministrisë, as tonin. Edhe ne mund të kemi qejf dhe themi ta heqim, siç mund të keni qejf edhe ju dhe doni ta hiqni nga DAP-i. Prandaj, argumenti nuk është bindës për mua të paktën. Ndaj po them që nuk është kjo arsyeja pse është vënë në këtë nen. Mbi të gjitha, ky ligj nuk është për këtë çështje që kemi. Projektligji që keni sjellë ka tjetër thelb.

Për thelbin që na keni sjellë neve jemi dakord. Tani të gjejmë një dritare, ku të futim një nen shkurtër dhe ta lëmë këtu në ligj që këta të jenë tërë jetën kështu, kjo nuk më duket normale.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e ka kërkuar zoti Çuçi.

**Bledar Çuçi** – Në parim, jam dakord me atë që tha kolegu Fino, por thjesht dua të përkrah edhe argumentin që dha zëvendësministrja, i cili lidhet pikërisht me ato pozicione në organizata publike që lidhen drejtpërdrejt me shërbimin, jo me shërbimin ndaj publikut në përgjithësi, por me komunikimin me qytetarin të këtyre pozicioneve. Gjendja civile është pikërisht një pozicion që kryen një shërbim të drejtpërdrejtë me qytetarët. Edhe ligji i shërbimit civil në frymë e në germë i trajton këto si pozicione që mund të dalin jashtë shërbimit civil.

E dyta, ka një specifikë për shërbimin e gjendjes civile, sepse është i vetmi funksion (dhe këtu zoti Fino e di shumë mirë, sepse të dy bashkë kemi hartuar ligjin për shërbimin e gjendjes civile) i deleguar sot në Shqipëri. Kjo do të thotë se përgjegjësia e shërbimit të gjendjes civile është e pushtetit qendror, ndërsa shërbimin e kryen pushteti vendor. Pra, ka një dualitet që krijohet për shkak të statusit që ka ky shërbim, si shërbim i deleguar në bashki dhe njësi administrative.

Kështu që mendoj se zgjedhja e bërë që në vitin 2003, kur kemi hartuar ligjin e shërbimit civil dhe ligjin për gjendjen civile, ka pasur pikërisht këtë parim: që këta punonjës nuk duhet të jenë në shërbim civil, pasi duhet të rregullohen me një marrëdhënie që kushtëzohet nga vendimmarrja e dy pushteteve, e pushtetit qendror dhe pushtetit vendor.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Jo, perfekti është si përfaqësuesi i pushtetit qendror, ajo është tjetër gjë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Unë merrem vetëm me parimin, nëse këta punonjës duhet të jenë punonjës që janë jashtë shërbimit civil, pra që rregullohen me Kodin e Punës, apo jo? Pa diskutim unë them se këta duhet të rrinë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çuçi!

Urdhëroni, zoti Doracaj!

**Bledar Doracaj** – Absolutisht, është i drejtë shqetësimi i ngritur nga deputetët. Dua të theksoj se prej pak vjetësh shërbimi në gjendjen civile ka ndryshuar. Pra, ne kemi një rregullore për pranimin e shërbimit të gjendjes, nuk ka më nëpunës dhe nuk do të ketë më nëpunës me shkollë të mesme që ofrojnë shërbime, por janë vënë disa kriterë arsimore. Pra, i gjithë pranimi në shërbimin e gjendjes civile bëhet mbi bazën e një rregulloreje dhe mbi bazën e testeve të organizuara nga Ministria e Brendshme.

**Ulsi Manja** - Në rregull, por nuk është ky thelbi i asaj që kërkoi zoti Fino.



*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** -... kjo nuk do të thotë se rregullorja që ke bërë ti, është një rregullore, e cila të krijon luksin që të marrësh punonjësit ashtu siç duhen, ndërkohë po ta bëjë testimin me DAP, nuk do të merren ata që duhen. Kjo nuk ka të bëjë fare, atë do ta bësh me rregullore. Natyrisht, do të marrësh me shkollë të lartë dhe shumë mirë. Por kjo na lidhje me diskutimin që po bëjmë ne. Nuk të kërkova si është gjendja e punonjësve të gjendjes civile. Thashë se me këtë ligj që vendos këtu, ti i jep mundësinë që të emërohen me Kod Pune dhe jo me konkurrim. Ky ishte thelbi i diskutimit tim.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

E hedhim në votim nenin 6, sipas variantit që është paraqitur.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet neni 6.

Neni 7.

**Elena Xhina** – Në nenin 7 janë pasqyruar disa ndryshime, ku në germat “d” dhe “g” heqin fjalët “njësi administrative”. Dua të sqaroj se gjatë gjithë frymës së ligjit janë hequr...

**Ulsi Manja** – Më fal, por jemi në nenin 7, ku thuhet “germa “c” në nenin 65 shfuqizohet”, pra jemi te varianti i qeverisë. Kurse neni 8 është pak më poshtë.

Ju lutem, jepini pak zonzjës projektligjin e qeverisë.

Neni 7 nuk ka ndryshime.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A është dakord ministria me nenin 7?

**Rovena Voda** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Ministria e Drejtësisë? Dakord.

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Neni 8.

**Elena Xhina** – Në nenin 8 nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja** – Nuk ka ndryshime as në nenin 8. A janë dakord ministrinë?

**Rovena Voda** – Dakord.

**Teuta Vodo** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Neni 9.

**Elena Xhina** – Edhe në nenin 9 nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja** – Dakord me nenin 9, sipas variantit të paraqitur?

**Rovena Voda** – Dakord.

**Ulsi Manja** - Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Neni 10.

**Elena Xhina** - Në nenin 10 ka disa ndryshime, të cilat janë bërë në rakordim me ekspertët dhe qeverinë dhe ndryshimi pasqyrohet në relacionin që u është paraqitur deputetëve.

**Ulsi Manja** - Kush është dakord me nenin 10, sipas formulimeve të propozuara nga relatorja? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 10.

Kalojmë te neni 11.

**Elena Xhina** – Neni 11 nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja** –Kush është dakord me nenin 11, i cili është një dispozitë kalimtare, që ka të bëjë me pezullimin për 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji të penalteteve që ka ligji aktual? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12.

**Elena Xhina**– Më fal, zoti kryetar!

Jemi ende te neni 10, pasi këshilltarja më thotë se në nenin 46, në pikat 1 dhe 61 dhe në germën “c”, pikat 62, 63, pika 3 dhe pika 65, hiqen fjalët “njësi bashkiake” dhe “njësi administrative” dhe shoqërohen gjatë gjithë ligjit.

**Ulsi Manja** – Më fal, atë e votuam me ndryshimet e propozuara. Mos më ngatërroni në votim, sepse neni 10 është votuar sipas ndryshimeve të propozuara në relacionin që kam përpara.

Kalojmë te neni 12, i cili ka të bëjë me hyrjen në fuqi të ligjit. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kush është dakord me propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në tërësi.

Kalojmë te nisma e deputetëve për ligjin për gjendjen civile, për të cilën kanë punuar edhe një grup ekspertësh. Ekspertët mund të ndërhyjnë. Ju lutem, relatorja të ndjekë projektligjin, i cili është nismë e deputetëve.

Kalojmë në votimin e nenit 1.

**Elena Xhina** – Zoti kryetar, neni 1 ka një ndryshim në paragrafin e katërt, i cili ka një riformulim dhe u është vënë deputetëve përpara.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 1, sipas një riformulimi që propozon relatorja?

**Viktor Gumi-Po**, dakord.

**Ulsi Manja** – Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka  
Miratohet.

Kalojmë te neni 2.

**Elena Xhina** – Neni 2 nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja**- Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.  
Miratohet neni 2.

Kalojmë te neni 3.

**Elena Xhina** –Neni 3 nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja** – Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.  
Miratohet neni 3.

Kalojmë te neni 4.

**Elena Xhina** – Neni 4 nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja** – Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.  
Miratohet neni 4.

Kalojmë te neni 5.

**Elena Xhina** – Neni 5 nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja**- Kush është pro me nenin 5?

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi**- Faleminderit, zoti kryetar!

Po diskutojmë ndryshimet e projektligjit, që është nismë deputeti, ndërkohë nga ekspertët neve na janë paraqitur disa amendamente për riformulimet e bëra. Unë kam një pyetje për ekspertët dhe për relatoren. A janë marrë në konsideratë propozimet e sjella për t'i riparë nenet e depozituara, apo jo?

**Ulsi Manja** –Relatorja!

**Elena Xhina** – Po, janë pasqyruar në draft dhe vijnë në tekstin e paraqitur këtu.

**Ulsi Manja**- Do të jenë në nenet e mëpasshme?

**Elena Xhina** – Po, janë pas nenit 6.

**Kalojmë te nenin 5...**

E hedhim në votim.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 5.

Kalojmë te neni 6.

**Elena Xhina** - Nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja** – Nuk ka ndryshime neni 6?

Atëherë, e hedhim në votim nenin 6.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 6.

**Elena Xhina** – Zoti kryetar, pas nenit 6 propozohet të shtohen dy nene të reja, me përmbajtjen e paraqitur në relacion, ku bëhet fjalë për rastet e deklarimeve të vdekjeve dhe çregjistrimet në këto raste, për propozimet dhe amendamentet e paraqitura nga ekspertët.

**Ulsi Manja** - Ekspertë, janë rakorduar këto dy shtesa që propozohen?

**Viktor Gumi** – Po, është edhe në iniciativën e parë, si dhe është diskutuar edhe gjatë takimit që bëmë para disa ditësh.

Atëherë, kush është dakord...?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** - Te pika 2, ju thoni: “Në fund të pikës 4, shtohet kjo përmbajtje: “Rregullat e hollësishme për zbatim e këtij paragrafi, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe ministrat që mbulojnë institucionet e përmendura në këtë paragraf.””” Do të ishte më mirë të thuhet “në këtë nen”, sesa “në këtë paragraf”, se duket sikur po bëjmë rregullore për çdo paragraf. Neni e përmbledh edhe paragrafin, apo e kam gabim?

**Viktor Gumi** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Jemi dakord me sugjerimin e kolegut Fino.

Ka zonja Hysi një sugjerim.

**Vasilika Hysi** – Është i drejtë shqetësimi që ngriti kolegu Fino, por ne mund të bëjmë një riformulim: “Rregullat e hollësishme për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në

paragrafin e dytë të këtij neni, rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrit”, domethënë nga ana e teknikës legislative, dhe kjo duhet parashikuar edhe në nenin e fundit që ka shtuar relatorja. Për të pasur një nen, brenda sa kohësh duhet të dalë ky akt, udhëzim i përbashkët i dy ministrave? Pra, kjo duhet të jetë e detajuar.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Hedhim në votim propozimin e relatores dhe të ekspertëve, për shtimin e një neni të ri pas nenit 6. Pas nenit 6, shtohet nenin 6/1, me përmbajtje sipas relacionit përkatës.

Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet shtimi i një neni të ri, nenit 6/1 në tekstin e projektligjit.

Kalojmë te neni 7.

**Elena Xhina** – Neni 7 nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja** - Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te neni 8.

**Elena Xhina** – Te neni 8 kemi shtimin e një paragrafi, me përmbajtje sipas relacionit, që bëhet me propozim për të hequr gjobën në rastet kur deklarimi i vdekjes nuk bëhet në afatin e parashikuar në pikën 3 të nenit 52 të ligjit.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Xhina!

Jeni dakord me nenin 8, me sugjerimet që propozon relatorja?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9, hyrja në fuqi e ligjit.

**Elena Xhina** – Zoti kryetar, përpara se të kalojmë te hyrja në fuqi e ligjit, dua të lëmë të hapur mundësinë për të bërë një parashtrim në fund, që të zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për aq sa është e mundur në këtë projektligj, pasi kemi shumë referenca te Kodi i Procedurës Civile. Pra, në fund të vëmë një dispozitë ku të kemi disa parashikime që i referohen Kodit të Procedurës Civile.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, të themi që mund të zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për aq sa është e mundur në këtë ligj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Më fal, unë kam një propozim këtu, që thotë: “Në fund të projektligjit, të shtohet një nen i ri që parashikon daljen e akteve nënligjore, si dhe afatin 3-mujor për nxjerrjen e tyre” dhe nuk kam sugjerim tjetër.

Ekspertë, keni diçka për të thënë për këtë që shtron për diskutim relatorja?

**Viktor Gumi** – Ne me relatoren e diskutuam pak më parë dhe nuk është e shkruar në dokument. Në parim, nuk kemi ndonjë gjë kundër që të bëhet një nen referencë në Kodin e Procedurës Civile, me institutet dhe parashikimet e tjera që ka.

**Ulsi Manja** – Ky do të jetë një nen deklarativ, një nen që i referohet Kodit të Procedurës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nëse palët do t’i drejtohen gjykatës, patjetër që kjo do të ketë referencë te Kodi i Procedurës Civile.

**Elena Xhina** – Ne në këtë projektligj i kemi përmendur disa referenca, duke marrë në konsideratë edhe kompetencën territoriale, edhe subjektet që ngenë padinë. Prandaj, mendoj se do të ishte më e qartë dhe do t’i hidhnim më shumë dritë projektligjit nëse do t’i vendosim në këtë projektligj.

**Ulsi Manja** – Unë kam një pyetje më tepër për sqarim. Çfarë i shton më tepër projektligjit ky nen që propozohet te Kodi i Procedurës Civile?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Por kjo është te parimet përgjithshme.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

A ka ndonjë riformulim për këtë gjë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk keni ndonjë riformulim?

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** - Shqetësimi që ngre zonja Elena është një problem, të cilin e kemi diskutuar disa herë në komisionin tonë. Si në rastin e ligjit “Për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare”, ashtu edhe në ligjin “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ne kemi aspekte procedurale të rregulluara me një ligj të thjeshtë. Ndërkohë, në diskutim është vënë raporti i një ligji të thjeshtë me Kodin e Procedurës Civile. Kryesisht ne kemi pranuar tashmë, ka disa raste, pra ky nuk është rasti i parë, që mund të jetë mbrojtja e viktimës apo mbrojtja e drejtave të shtetasve, të kemi procedura të thjeshta lehtësuese. Pa dyshim, kur një çështje shkon në gjykatë, gjyqtarët do t’i referohen Kodit të Procedurës Civile.

Unë mendoj se nëse do ta vendosim këtë dispozitë këtu, atëherë të gjithë gjyqtarët do t'i referohen Kodit të Procedurës Civile dhe do t'i anashkalojnë rregullat që ne kemi parashikuar në trajtimin e regjistrimit të fëmijëve në gjendjen civile. Ky është diskutimi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zoti Fino, edhe unë ndaj të njëjtin mendim me ju, por përderisa tani ne kemi një ligj për të rregulluar regjistrimin e fëmijëve, i cili është më se e qartë, hajdeni të zbatojmë ligjin. Përndryshe, ne mund të rregullojmë çdo aspekt që lidhet me regjistrimin e fëmijëve në Kodin e Procedurës Civile.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Gumi.

**Viktor Gumi** - Ne besojmë se në kuptimin e frymës së ligjit mund të hartojmë një dispozitë. Teksti i dispozitës do të jetë i thjeshtë me një natyrë referente, i cili nuk do të vendosë rregulla të posaçme jashtë rregullave ligjore. Pra, mund të jetë thjeshtë një referencë, sikundër përdoret, dhe ka teknikë legjislative, që e përdor këtë referencë të jashtme.

**Ulsi Manja** – Nga Ministria e Drejtësisë, zoti Bego.

**Ilir Bego** - Faleminderit, zoti kryetar!

Ne kemi një rast të pastër të përballjes së qytetarit me një organ shtetëror dhe këtu vlen Kodi i Procedurave Administrative. Në Kodin Civil rregullohet marrëdhënia shtetas me shtetas dhe marrëdhënia subjekte civile në rastet kur këta nuk e kanë zgjidhur vetë atë pjesë. Pra, në rastin e një kontrate, ajo pjesë që nuk është e përcaktuar në kontratë midis palëve, këtë gjë e rregullon Kodi Civil. Kjo është pjesë e pastër administrative, ku një qytetar përballet me një organ shtetëror. Referencat e Kodit Civil, zhvillimi i procedurës gjyqësore sipas Kodit Civil më duket i pavend edhe për shkak të barrës së provës në një proces të tillë gjyqësor.

**Ulsi Manja** – Dakord. Unë bashkohem me mendimin e zotit Gumi, sepse ky është një nen më tepër i karakterit preferencial, pra thjeshtë është deklarativ. Unë mendoj të mos e mbingarkojmë ligjin me këtë.

Hedhim në votim nenin 9, që ka të bëjë me hyrjen në fuqi të ligjit.

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Në relacion është thënë se do të shtohet një nen i ri për nxjerrjen e akteve nënligjore. Neni i akteve nënligjore është detyrim kushtetues. Pra, neni duhet i detajuar.

**Ulsi Manja** – Më fal, të lutem! Pasi të votojmë në tërësi projektligjin, që është nismë e deputetëve, do të votojmë edhe projektligjin si tekst integral, ku është parashikuar saktësisht kohëzgjatja e nxjerrjes së akteve nënligjore.

**Vasilika Hysi** – Ky është propozimi im. Në projektligj ne do të vendosim jo vetëm detyrimin e nxjerrjes së akteve nënligjore në afatin kohor, por edhe llojin e akteve dhe kush do ta nxjerrë. Do të themi: “Në mbështetje të nenit kaq, paragrafi kaq i këtij ligji, ngarkohet ministri përgjegjës për gjendjen civile që të nxjerrë aktin brenda tri muajve, në mbështetje të paragrafit 2 të këtij neni” e të tjera. Pra, duhet të jetë e përcaktuar dhe këtë detyrë mund ta bëjë shumë mirë stafi i Kuvendit.

Kam edhe një sugjerim, zoti kryetar, me të drejtë grupi i ekspertëve dhe relatorja, mbas nenit 6 kanë shtuar edhe dy nene të tjera. Do të doja që rreshtimi i neneve, para miratimit të ligjit në variantin integral, të bëhet sipas rendit. Pra, nga neni 52 nuk do të kalohet te neni 53, pa bërë çdo rregullim te neni 52. Pra, duhen sistemuar.

**Ulsi Manja** – Të lutem, zonja Hysi, do të shprehemi me votë për bashkimin e dy projektligjeve në një tekst integral, ku është e përcaktuar ndërhyrja sipas renditjes. Pra janë bashkuar te dyja nismat dhe do të kemi një tekst integral.

Kalojmë te neni 9. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009” “Për gjendjen civile”, i ndryshuar”, nismë e deputetëve? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Siç ramë dakord edhe në mbledhjen e radhës për të dyja nismat, meqenëse bëhet fjalë për ndërhyrje në të njëjtin ligj, do t’i bashkojmë të dyja nismat në një projektligj të vetëm dhe seancës plenare do t’i dërgojmë për votim një tekst integral të projektligjit së bashku me relacionin përkatës.

Kush është dakord me bashkimin e dy projektligjeve në një tekst integral? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009” “Për gjendjen civile”, i ndryshuar”, sipas tekstit integral.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

I përfshin të dyja nismat.

**Bashkim Fino** – Projektligji është gati të kalojë të enjten, por, nëse relatorja me këshilltarët, na lënë një kopje nesër të tekstit integral, që edhe ne ta shohim, do të ishte një gjë shumë e mirë, sepse nuk e kemi, që të jenë të qartë të dyja ministrinë, këshilltarët, por edhe ne.



**Ulsi Manja** – Në fakt, shqetësimi i kolegut Fino është i drejtë dhe unë e kam një kopje të tekstit integral përpara, por do ta shpërndajmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jam shumë dakord.

Këtu mbyllet mbledhja për ditën e sotme. Ju uroj një ditë të mbarë!

Mbledhja e radhës do të njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**